



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

Nr. 130 prot

Tiranë më 02/09/2022

Lënda: Raport mbi studimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së PKSH/PPSH dhe rekomandime.

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Znj. Lindita Nikolla

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

Znj. Klotilda Bushka

Ky është një raport përmbledhës mbi studimin e veprimtarisë së Partisë Komuniste Shqiptare – PKSH (më vonë, Partia e Punës e Shqipërisë – PPSH), bazuar në literaturë të botuar nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK), në përmbushje të detyrës ligjore të tij. Literatura mbështetëse është dhënë në fund të raportit.

BAZA LIGJORE DHE DETYRAT

ISKK është krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”. Detyrat kryesore të ISKK, parashikuar në këtë ligj, janë:

Neni 5:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;*
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;*
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;*

c) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;

d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;

dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;

e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;

ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;

f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;

g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;

gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;

h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;

j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;

k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.

QËLLIMI

Ky raport ka për qëllim informimin e Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në ligjin 10242, 25 shkurt 2010, neni 5, pika i, me rezultatet e kërkimeve shkencore të ISKK, mbi krijimin, gjendjen juridike, dhe veprimtarinë e organit kryesor të diktaturës komuniste në Shqipëri, PKSH/PPSH.

OBJEKTI

Ky raport është një përmbledhje e përfundimeve të nxjerra nga studimi dhe vlerësimi i mënyrës së krijimit, gjendjes juridike, dhe ushtrimit të veprimtarisë së PKSH/PPSH, në përputhje me përmbajtjen e germës a, b, c, d, të nenit 5, të Ligjit nr. 10242, i cili bazohet në kërkimet arkivore, studimet shkencore dhe botime të tjera të realizuara nga specialistët e ISKK dhe bashkëpunëtorët e tij.

METODOLOGJIA

Për studimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së PKSH/PPSH janë përdorur metodat bazë të njohura në fushën e kërkimit shkencor: hulumtimi, përshkrimi, krahasimi, sinteza dhe analiza. Synimi kryesor gjatë përdorimit të metodës së hulumtimit ishte shfrytëzimi i burimeve parësore. Duke qenë të vetëdijshëm për natyrën manipuluese të propagandës zyrtare jemi përpjekur që të dhënat t'i verifikojmë me kryqëzim dokumentesh, ose jemi përpjekur ta ndjekim informacionin deri në burimin fillestar. Për shembull, kur kemi gjetur një raport të caktuar të përgatitur nga Byroja Politike e PKSH/PPSH, atëherë jemi përpjekur të gjejmë burimin fillestar në lidhje me këtë informacion, që mund të ishte Këshilli i Ministrave, ose ndonjë institucion tjetër më poshtë në hierarki. Një rëndësi të veçantë u kemi kushtuar dokumenteve të institucioneve ekzekutive dhe procesverbaleve, të cilat përgjithësisht i trajtojnë çështjet më me pak retorikë propagandistike.

Metoda mbizotëruese e përdorur është analiza, e cila buron nga hulumtimi dhe dokumentet, ku vendin më të rëndësishëm e zënë dokumentet arkivore. Gjatë analizës ka qenë parësore përpjekja për ta ruajtur atë, zhveshur, nga subjektiviteti dhe qëndrimet emocionale, në përpjekje për të realizuar një analizë sa më të paanshme, në respektim të etikës së studimit shkencor dhe në përmbushje të detyrimit që rrjedh nga germa a, neni 5, i Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010. Veprimtaria e PKSH/PPSH, e cila në Ligjin nr. 10242, neni 5, germa d, cilësohet si “kriminale”, është studiuar dhe vlerësuar në raport me kornizën ligjore të kohës dhe ligjet ndërkombëtare të nënshkruara nga shteti shqiptar.

HYRJE

PKSH/PPSH u krijua më 8 nëntor 1941 dhe veproi përtej datës 8 dhjetor 1990, e cila, në Ligjin nr. 10242, neni 3, germa a, është caktuar si fundi i periudhës së komunizmit në Shqipëri. Në periudhën 1941-1946, PKSH/PPSH veproi si një entitet i paregjistruar juridikisht. Ilegaliteti (paligjshmëria) i saj për periudhën 8 nëntor 1941-29 nëntor 1944 ka qenë dhe është një fakt i pranuar publikisht, madje i glorifikuar në letërsi dhe kinematografi (“Ilegalët” është përdorur si titull filmi, poeme, e poezish gjatë regjimit komunist). Gjatë kësaj periudhe PKSH ka ushtruar dhe veprimtari që nuk mund të përkufizohen si veprimtari politike; ekzistojnë vendime të Komitetit Qendror (KQ) të saj për dënimin me vdekje të personave të caktuar. Në periudhën 29 nëntor 1944-6 dhjetor 1946, PKSH/PPSH vazhdoi të vepronte si entitet i paligjshëm në nivelet më të larta të pushtetit në Shqipëri, në mungesë të një ligji që lejonte krijimin e partive politike dhe rregullonte veprimtarinë e tyre.

BAZA LIGJORE PËR REGJISTRIMIN E PARTIVE POLITIKE TË REJA OSE EKZISTUESE DHE RREGULLIMI I VEPRIMTARISË SË TYRE, 1946-1990

Më 1946, me miratimin e kushtetutës, e cila garantoj të drejtën e organizimit politik, dhe me daljen e ligjit që rregullonte veprimtarinë e entiteteve politike, u krijua një kornizë ligjore, e cila rregullonte, juridikisht, veprimtarinë politike në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit.

Gjatë periudhës së komunizmit, organizimi politik i qytetarëve (shtetasve) ishte i garantuar, bazuar në këto dokumente ligjore:

- Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (Dekret nr. 24, 15 mars 1946), neni 18:
“Të gjithë shtetasve u garantohej liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik.”
Me amendimet që iu Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë (Dekret nr. 1097, 4 korrik 1950), neni për lirinë e fjalës dhe organizimin politik mori numrin 20. Emërtimi i dokumentit ndryshoi, nga “statut” në “kushtetutë”.
- Kushtetuta e Republikës Socialiste të Shqipërisë (Ligj nr.5506, 28 dhjetor 1976), neni 53:
“Shtetasit gëzojnë lirinë e fjalës, të shtypit, të organizimit, të grumbullimit, të mbledhjes, dhe të manifestimit publik. Shteti garanton realizimin e këtyre lirive, krijon kushte për to dhe vë në dispozicion mjetet e nevojshme.”

Veprimtaria e parti politike rregullohej nga ky dokument ligjor:

- Ligji nr. 370, 6 dhjetor 1946, *“Mbi formimin e partive politike dhe shoqatave kulturale, shkencore, profesionale etj., dhe mbi mbledhjet publike.”*
Ky ligj e humbi fuqinë me daljen e Dekretit nr. 7442, 17 dhjetor 1990, *“Për krijimin e organizatave e shoqatave politike”*.

DISPOZITAT E LIGJIT NR. 370, 6 DHJETOR 1946

1. Dispozitat detyruese

Me miratimin e Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946, *“Mbi formimin e partive politike dhe shoqatave kulturale, shkencore, profesionale etj., dhe mbi mbledhjet publike,”* u rregullua me ligj të veçantë detyrimi kushtetues për mundësimin e qytetarëve që të ushtronin të drejtën e tyre të organizimit politik (përfshi krijimin e partive) dhe rregullimi i një situatë ekzistuese lidhur me individët dhe entitetet që zhvillonin tashmë veprimtari politike.

Me daljen e këtij ligji, koncepti parti politike ishte një koncept ligjor. Asnjë entitet me pretendimin se ishte parti politike, nuk mund të ishte i tillë, nëse nuk përmbushte kushtet e parashikuara në ligj. Pra, partia politike ishte një entitet juridik.

Ligji nr. 370, 6 dhjetor 1946, parashikonte që:

- Neni 3
“Shtetasit që dëshirojnë të formojnë parti politike detyrohen t’i drejtojnë një kërkesë organit shtetëror kompetent duke paraqitur programin dhe rregulloren ose statutin e partisë së tyre.”

- *Neni 4*

Kërkesa për formimin e një partie politike duhet të nënshkruhet të paktën nga 50 zgjedhës kur veprimtaria e kësaj partie do të shtrihet në rrethin e një ose dy prefekturave dhe nga 100 zgjedhës kur veprimtaria e saj do të shtrihet në rrethin e tre ose më shumë prefekturave ose në gjithë Shqipërinë.

- *Neni 5*

Kërkesa për formimin e një partie politike i drejtohet Ministrisë së P. të Brendshme, e cila kur konstaton mungesa formale, ua kthen paraqitësve për t'i plotësuar e korrigjuar.

Këto dispozita ishin të vlefshme për krijimin e partive politike të reja. Mirëpo, të vetëdijshëm për ekzistencën e entiteteve politike para daljes së këtij ligji, ligjvënësit parashikuan formalizimin e tyre entiteteve; një prej këtyre entiteteve ishte PKSH/PPSH. Ligji 370 kishte një dispozitë të veçantë për regjistrimin e partive që ekzistonin para daljes së ligjit.

- *Neni 31*

Partitë dhe organizatat politike si dhe shoqatat e ndryshme që ekzistojnë para hyrjes në fuqi të kësaj ligje duhet të t'u konformohen urdhërimeve të kësaj ligje brënda 6 muajve nga data e shpalljes së saj në "Gazetën Zyrtare".

2. Dispozitat lejuese

Parti politike, në përkufizim juridik, ishte ai entitet që kishte përmbushur detyrimin ligjor procedural të regjistrimit, si kusht për të ushtrimin e aktivitetit politik.

- *Neni 12*

Partitë politike janë persona juridikë. Ato munt të kenë pasuri të patundshme të nevojshme për qëllimet e partisë, lokale për mbledhje dhe shtypin e tyre. Këto parti administrojnë t'ardhurat që rrjedhin nga pagimi i kuotave të anëtarësisë si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

3. Dispozitat ndëshkuese

Ligji kishte një kapitull të veçantë, të titulluar "Dispozita ndëshkuese dhe tranzitore", prej të cilit citojmë:

- *Neni 27*

Kushdo që shkel dispozitat e kësaj ligje në lidhje me lajmërimin për formimin e partive politike... dënohet me gjobë gjer në 500 fr. përveç kur vepra formon faj penal më të rëndë...

- *Neni 29*

Kushdo që merr pjesë si nëpunës pranë partive politike ose shoqatave të palejuara, dënohet me privim të lirisë personale gjer në 1 vit, kurse anëtarët e këtyre partive, shoqatave dënohen me privim të lirisë personale gjer në tre muaj ose me gjobë gjer në 500 fr. përveç rastit kur vepra e tyre formon faj më të rëndë.

GJENDJA JURIDIKE E PKSH/PPSH, 6 DHJETOR 1946-8 DHJETOR 1990

1. Rezultatet e kërkimit arkivor

Puna për studimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së PKSH/PPSH nisi duke kërkuar dokumentet ligjore që vërtetnin ekzistencën e saj, nisur nga fakti që parti politike ishte ai entitet që ishte krijuar dhe kishte vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946.

Specialistët e ISKK kërkuar dokumente për të vërtetuar ekzistencën juridike të PKSH/PPSH, si pikë fillestare për vazhdimin e studimit dhe të vlerësimit të veprimtarisë së saj, por nuk gjetën dokumente të tilla. Edhe kërkuesit shkencorë të institucioneve të tjera, ose studiuesit në profesion të lirë, të cilët merren me studimin e historisë së periudhës së komunizmit dhe që janë pyetur, nëse kishin ndeshur gjatë kërkimeve të tyre dokumente që dëshmonin regjistrimin e PKSH/PPSH si parti politike, kanë dhënë përgjigje negative.

Meqenëse ligji parashikonte që regjistrimi i partive politike bëhej pranë Ministrisë së Brendshme, në kërkim të një përgjigjeje shteruese, ISKK iu drejtua me shkresë zyrtare Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme (i njohur si Arkivi i Ministrisë së Brendshme) me shkresë nr. prot 164, 2 dhjetor 2021, duke i kërkuar informacion nëse ekzistonin pranë atij arkivi dokumente të subjekteve të mundshme që mund të jenë regjistruar gjatë periudhës 1946-1990, në përputhje me Ligjin. 370, 6 dhjetor 1946. Ai arkiv ka në ruajtje gjithë dokumentet e prodhuara nga Ministria e Punëve të Brendshme gjatë regjimit komunist, dhe, parimisht, aty duhet të ekzistonte një fond ose dosje me dokumentet e regjistrimit të partive politike dhe organizatave të tjera.

Me shkresë nr. prot. 9076/4, 10 dhjetor 2021, Arkivi na informoi se ai institucion “nuk disponon informacion të këtij lloji.” Bazuar në këtë shkresë, mund të themi se në periudhën 1946-1990 nuk janë kryer procedura regjistrimi për partitë politike ose organizata të tjera, detyrim që rridhte nga Ligji nr. 370, 6 dhjetor 1946.

Rezultati i kërkimit arkivor është se PKSH/PPSH nuk ka ekzistuar, juridikisht, si parti politike.

2. Argumente shtesë për mosekzistencën juridike të PKSH/PPSH

Fakti që PKSH/PPSH nuk është regjistruar si parti politike, në përputhje me dispozitat në fuqi, është i vërtetuar dhe nga studimi dhe vlerësimi i provave të tërthorta.

Një nga kushtet për regjistrimin e një partie politike ishte dorëzimi rregullores ose statutit pranë Ministrisë së Brendshme. Më 6 dhjetor 1946, dhe gjashtë muaj më vonë, kur skadonte afati i regjistrimit e partive që ekzistonin para daljes së Ligjit. Nr. 370, PKSH/PPSH nuk kishte statut të saj, dorëzimi i të cilit pranë Ministrisë së Brendshme ishte një nga kushtet për regjistrimin e partisë.

Në librin “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë” (botim i Institutit të Studimeve M-L, 1981, fq 247) thuhet: “Për shtatë vjet me radhë [PKSH] e kishte rregulluar jetën e saj të brendshme mbi bazën e vendimeve, qarkoreve dhe udhëzimeve.” Në veprën “Fjalori Enciklopedik Shqiptar” (botim i Akademisë së Shkencave, viti 1985, fq. 801), thuhet se statuti i PKSH (PPSH) u miratua

në kongresin I të saj, më 1948. Ky statut, dy vjet me vonesë nga dalja e Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946, nuk u dorëzua kurrë në Ministrinë e Brendshme, në përpjekje për regjistrimin e partisë. Pra, në periudhën e afateve ligjore për regjistrim, dhjetor 1946-qershor 1947, PKSH/PPSH nuk zotëronte dokumentacionin e nevojshëm për ta dorëzuar pranë Ministrisë së Brendshme. Nëse PKSH/PPSH do të kishte tentuar regjistrimin në mungesë të statutit, atëherë duhet të ekzistonte procedura zyrtare e refuzimit të kërkesës së saj, në respekt të dispozitave të Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946.

VEPRIMTARIA E PKSH/PPSH SIPAS DISPOZITAVE NDËSHKUESE TË LIGJIT NR. 370, 6 DHJETOR 1946

Fakti që PKSH/PPSH nuk ekzistonte juridikisht si parti politike nuk do të thotë që ajo ishte jo ekzistente si entitet. Ajo ekzistonte, nga këndvështrimi ligjor, si entitet i paligjshëm.

Paligjshmëria ishte kategori juridike penale e përkufizuar në dispozitat ndëshkuese të Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946, dhe në kodin penal në fuqi.

Duke qenë entitet i pa regjistruar, veprimtaria e PKSH/PPSH ishte një seri e gjatë fajesh penale. Po rendisim disa nga veprat penale të PKSH (PPSH) ose anëtarëve të saj të kryera në shkelje të Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946:

1. Ushtrimi i veprimtarisë politike në mungesë të statusit juridik për të ushtruar një veprimtari të tillë.
2. Anëtarësimi i paligjshëm në një entitet politik të paligjshëm.
3. Veprime financiare të paligjshme (mbledhja e kuotizacioneve, pagesa e nëpunësve, etj)
4. Marrja në mënyrë të paligjshme e fondeve nga burime të tjera (buxheti i shtetit)
5. Pronësi e paligjshme mbi zyrat e PKSH/PPSH, komitetet e partisë në rrethe (ose përdorimi i paligjshëm i objekteve shtetërore për zyra, etj.) dhe objekte të tjera
6. Punësimi i paligjshëm i njerëzve në strukturat e një organizate të paligjshme (Byro Politike, Komitet Qendror, komitet e partisë në rrethe, etj.)
7. Nxjerrja e paligjshme e shtypit (gazeta e partisë)

Veprimtaria e paligjshme e PKSH (PPSH) është më e gjerë se kaq, ajo përfshin vepra penale më të rënda të përkufizuara si kategori juridike në kodet penale të kohës dhe ligje të tjera.

SHKELJA E RENDIT KUSHTETUES NGA PKSH/PPSH

Në periudhën 1946-1990, regjimi përdori disa dokumente ligjore ndëshkuese, që quheshin, si edhe sot, kode penale.

Kodet Penale të periudhës 1946-1990:

1. *Ligji nr. 372, 12 dhjetor 1946, "Mbi fajet penale kundra popullit dhe Shtetit" (Kodi Penal)*
2. *Ligji nr. 1470, 23 maj 1952, Kodi Penal*
3. *Ligji nr. 5591, 15 qershor 1977, Kodi Penal*

Në Platformën e Sigurimit (1948), dokument i përgatitur nga Byroja e Politike PKSH/PPSH, thuhet se, “Sikurse të gjitha organet e shtetit që drejtohen nga Partija e Punës së Shqipërisë, e cila është forca e vetme drejtonjëse në vendin t’tonë, për mbi të gjithë aparatin e shtetit dhe organizatat shoqërore, ashtu edhe organet e sigurimit të shtetit drejtohen nga Partija.”

Në këtë deklaratë, që ishte realisht e vërtetë, PPSH pranonte se drejtonte gjithë institucionet shtetërore, ndërkohë që vetë PPSH nuk ishte pjesë juridike e këtij shteti, për arsye që i kemi shpjeguar më sipër.

Më 1966, Enver Hoxha e pohoi këtë gjë në një formë tjetër. Ai tha se: “Ministria e Drejtësisë nuk është shtabi i diktaturës së proletariatit. Ky shtab përbëhet nga Kongresi dhe Komiteti Qendror i Partisë. Partia dhe Komiteti Qendror u kanë dhënë kompetenca Byrosë Politike, Qeverisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Gjykatës së Lartë dhe Ministrisë së Drejtësisë, që të veprojnë në bazë të direktivave të tyre. Pra, koka e diktaturës së proletariatit tek ne është Kongresi i Partisë dhe Komiteti Qendror, jo Ministria e Drejtësisë.”

Hoxha e deklaroi hapur këtu që PKSH/PPSH ishte mbi gjithë institucionet kushtetuese. Ky realitet ishte në shkelje të Kushtetutës (1946), e cila, në nenin 4 të saj, sanksiononte që: *“Të gjitha organet e pushtetit shtetëror ushtrojnë funksionet e tyre në bazë të Statutit [kushtetuta], të ligjëvet dhe të urdhëresave të përgjithshme të dhëna prej organeve të larta të pushtetit popullor. Të gjitha veprimet e organeve të administratës së shtetit dhe të gjykatave duhet të jenë të bazuara në ligjë.”*

Pra, kontrolli i PPSH mbi “gjithë aparatin e shtetit” ishte në shkelje të kushtetutës. Realisht, PPSH kishte përmbytur rendin kushtetues në Shqipëri.

Në nenin 2, të Ligjit nr. 372, 12 dhjetor 1946, “Mbi fajet penale kundra popullit dhe Shtetit”, thuhet se *“Konsiderohet faj penal kundra popullit dhe Shtetit çdo veprë e bërë... për të vënë në rrezik organizimin shtetëror të Republikës Popullore të Shqipërisë...”*. Organizimi shtetëror i përmendur në këtë dispozitë penale ishte i parashikuar në kushtetutë (rendi kushtetues), e cila nuk parashikonte asnjë rol të PPSH në marrëdhënie me institucionet kushtetuese. Rendi kushtetues në Shqipëri ishte përmbytur nga një organizatë e paligjshme.

Në Kodin Penal të vitit 1952 dhe 1977, vënia në rrezik e organizimit shtetëror nuk figuron më si veprë penale, në kapitullin krime kundër shtetit. Sidoqoftë, gjendja e rendit kushtetues të përmbytur vazhdoi deri në rënien komunizmit, sepse dispozita kushtetuese që Kushtetuta ishte ligji themeltar nuk ndryshoi asnjëherë.

Gjithë anëtarët e Byrosë Politike apo të KQ të PKSH, të cilët ishin dhe anëtarë të qeverisë ose deputetë në Kuvendin Popullor, ose zyrtarë të nivele të tjera, ishin në shkelje të ligjit, për pjesëmarrje në një organizatë të paligjshme siç ishte PPSH.

PKSH/PPSH emëronte dhe shkarkonte zyrtarë të nivele të ndryshme, nga drejtuesit dhe anëtarët e organeve kushtetuese, te nivelet më të ulëta, jo vetëm duke mos e pasur këtë atribut ligjor, por duke qenë një entitet i paligjshëm.

Numri i vendimeve të emërimit dhe shkarkimeve të kësaj natyre, përgjatë gjithë periudhës së komunizmit në Shqipëri, është i pafundëm. Vetëm me Vendim nr. 48, 7 maj 1990, Byroja

Politike e PKSH/PPSH, shkarkoi nga detyra një sekretar të përgjithshëm pranë Këshillit të Ministrave dhe emëroi ministër të Drejtësisë, shkarkoi kryetarin e Komisionit të Planit të Shtetit, shkarkoi zëvendëskryetarin e Gjykatës së Lartë dhe e emëroi kryetar të Gjykatës së Lartë, shkarkoi kryetarin e Gjykatës së rrethit Fier dhe emëroi nënkryetar të Gjykatës së Lartë. Për emërimet në dokument përdoret termi “rekomandohet të emërohet”, por rekomandimi ishte vendim për t’u zbatuar, sepse në realitet personat e rekomanduar morën postet e përcaktuara në vendimin e Byrosë Politike. E përmendim këtë vendim, sepse ishte në vitin e fundit të regjimit komunist, kur vetë drejtuesit e tij ndërmerrnin reforma që çuan në shembjen e tij.

Në Kushtetutë, neni 78, emërimi ose shkarkimi i ministrave të veçantë dhe zëvendësministrave ishte atribut i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ashtu siç ishte edhe emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të veçantë ose nënkryetarëve të Gjykatës së Lartë, etj.

Megjithëse, vendimarrja e Byrosë Politike, e kësaj natyre, vazhdoi dhe në fillim të vitit 1991. Për shembull, zgjedhjet parlamentare të parashikuara të mbaheshin më 10 shkurt 1991, u shtynë me vendim të Byrosë Politike dhe KQ të PKSH/PPSH.

FINANCIMI I PALIGJSHËM NGA BUXHETI I SHTETIT

PKSH/PPSH nuk ishte person juridik dhe, për rrjedhojë, çdo lloj veprimtarie financiare e saj bëhej në shkelje të Ligjit nr. 370, 6 dhjetor 1946 dhe të Kodit Penal.

Gjatë ekzistencës së saj, PKSH/PPSH kreu veprime financiare të ndryshme, që nga pagesa e rrogave të nënpunësve të saj deri te financimi i lëvizjeve komuniste në botë. Të ardhurat e saj siguroheshin nga kuotat e anëtarësisë, buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera. Të ardhurat më të mëdha ajo i siguronte nga buxheti i shtetit, bazuar në statistikat e 19 viteve që kemi studiuar deri tani. Shuma e përvitshme që PKSH/PPSH merrte nga buxheti i shtetit ishte 60%-80% të shpenzimeve vjetore të saj.

Përdorimi i paligjshëm i buxhetit të shtetit ishte vepër penale e parashikuar në Kodin Penal. Sipas Nenit 85 dhe 62 të Kodit Penal (respektivisht 1952 dhe 1977) *“përvetësimi i pasurisë shtetërore dhe shoqërore i kryer më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar personash ose në përpjestime të mëdha ose me grabitje, dënohet: me burgim jo më pak se shtatë vjet ose me vdekje, dhe jo kurdoherë me konfiskimin e pasurisë.”* Përvetësimi i paligjshëm i parave nga financat publike prej PKSH/PPSH përputhej plotësisht me përkufizimin penal: përvetësim i pasurisë socialiste i kryer më shumë se një herë, i kryer në grup dhe në përpjestime të mëdha.

KRIJIMI DHE DREJTIMI NGA PKSH/PPSH I NJË STRUKTURE TË PALIGJSHME NË VARËSI TË SAJ

Kontrolli i PKSH/PPSH mbi institucionet kushtetuese, institucionet e tjera dhe gjithë shoqërinë kryhej me anë të institucioneve të destinuara përmes mbrojtjes së rendit e sigurisë ose sovranitetin e shtetit. Ajo kontrollonte në mënyrë ekskluzive Sigurimin e Shtetit, Ministrinë e Brendshme, dhe Ushtrinë, dhe, sigurisht, me anë të anëtarëve të saj, të organizuar në mënyrë të paligjshme, që i kishte punësuar në gjithë institucionet, sidomos ata të nivele të larta.

Sigurimit të Shtetit ishte një entitet i armatosur i paligjshëm. Nuk ekziston një ligj për krijimin dhe rregullimin e veprimtarisë së tij. Bazuar në studime të botuara, Sigurimi i Shtetit u krijua nga PKSH/PPSH, më 20 mars 1943.

Më 1 qershor 1990, në mbledhjen e Byrosë Politike u zhvillua ky dialog:

ADIL ÇARÇANI (kryeministër dhe anëtar i Byrosë Politike): *"Si ta vëmë punën e organeve të policisë mbi baza ligjore? Po punën e organeve të Sigurimit e kemi vënë mbi baza ligjore?"*

SIMON STEFANI (ministër i Punëve të Brendshme dhe anëtar i Byrosë Politike): *"Për punën e Sigurimit, përveç urdhrave që nxjerr Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të ligjeve, punën tonë e kemi të ndërtuar mbi bazën e Platformës së Byrosë Politike. Ne nuk kemi ligje të aprovuara as për zbulimin, as për Sigurimin e Shtetit."*

Policia dhe Sigurimi, të cilat kishin vepruar në mënyrë të paligjshme deri atëherë, ishin struktura të Ministrisë së Brendshme, e cila, pavarësisht se juridikisht ishte organ i Këshillit të Ministrave, në realitet varej nga Byroja e Politike e PKSH/PPSH, dhe veprimtaria e saj ishte bazuar, si domumenti themelor, në një dokument të nxjerrë nga Byroja Politike, i cili emërtohej platformë. Gjatë periudhës së komunizmit, Byroja e Politike e PKSH/PPSH nxori disa platforma:

1. *Platforma Politike dhe Organizative e Sigurimit të shtetit (1948)*
2. *Platforma e Punës Operative të Organeve të Punëve të Brendshme (Vendim nr. 30, 8 shkurt 1954)*
3. *Platforma e Punës Operative të Organeve të Punëve të Brendshme (Vendim nr. 213, 4 korrik 1958)*
4. *Platforma e Punës Operative të Organeve të Punëve të Brendshme (Vendim nr. 116, 14 korrik 1966)*
5. *Platforma e Punës Operative të Organeve të Punëve të Brendshme (25 gusht 1977)*
6. *Platforma e Punës Operative të Organeve të Punëve të Brendshme (12 shkurt 1985)*

Platformat përdorshin në mungesë të ligjit për rregullimin e punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, por, referuar korpusit ligjor të kohës, ato ishin pa vlerë juridike, pse ishin nxjerrë nga një entitet, i cili nuk kishte autoritet ligjor për të nxjerrë dokumente të tilla.

Parimi themelor i punës së organeve të ministrisë së Punëve të Brendshme, i përsëritur në të gjitha platformat, ishte kontrolli i plotë dhe i pandërprerë i PKSH/PPSH mbi ato organe. Ministri i Punëve të Brendshme raportonte, sipas radhës, në KQ të PKSH/PPSH dhe Këshillin e Ministrave. Pra, KQ i PKSH/PPSH, strukturë e një entiteti të paligjshëm e vendoste veten sipër Këshillit të Ministrave, i cili ishte institucion kushtetues dhe, me kushtetutë, përgjigjej vetëm përpara Kuvendit Popullor.

Platforma e Sigurimit të Shtetit autorizonte rekrutimin e njerëzve në shërbim të Sigurimit të Shtetit. Të rekrutuarit kryenin detyra të ndryshme, në dokument ata emërtohen: agjent, informator, rezident, strehues. Rekrutimi i tyre bëhej me forcë (masa shtrënguese) ose mbi baza vullnetare. Të rekrutuarit e të katër llojeve drejtoheshin nga operativi dhe, si grup, quheshin rrjet

agjental. Puna e tyre ishte përgjimin e personave që u caktonin drejtuesit e rrjetit. E gjithë veprimtaria e tyre ishte e pa bazuar në ligj.

PKSH/PPSH autorizonte me anë të platformës arrestimin, hetimin dhe burgosjen e njerëzve, ndërkohë që, edhe PKSH/PPSH edhe Sigurimit, ishin entitete të paligjshme. Përdorimi i këtyre termave ishte abuziv, sepse, realisht, në mungesë të bazës ligjore për platformën, koncepti arrestim në platformë ishte rrëmbim i personit; hetimi ishte shtrëngim, intervistim i paligjshëm; burgosja ishte heqje e paligjshme e lirisë së personit. Këto vepra mund të quheshin arrestim, hetim dhe burgosje, nëse bëheshin në bazë të koncepteve juridike të përkufizuar në ligj dhe në përputhje me procedurat ligjore.

PKSH/PPSH e autorizonte Sigurimin e Shtetit të hapte korrespondencën, fshehtësia e të cilës mbrohej me Kushtetutë, neni 21 (1946), neni 24 (1950), neni 58 (1976).

Përmbajtja e platformave të mëvonshme ishte e njëjtë me atë të Sigurimit të Shtetit, por, në vend të termit Sigurim i Shtetit përdorej organet e Punëve të Brendshme. Në këto platforma shfaqen dhe referenca ligjore, por kjo nuk mund t'i jepte autoritet ligjor platformës, kur entiteti që e kishte nxjerrë ishte i paligjshëm. Mendësia e drejtuesve të PKSH/PPSH për ligjshmërinë ishte ajo që shprehu Simon Stefani, anëtar i Byrosë Politike të PPSH dhe ministër i Punëve të Brendshme, në mbledhjen e Byrosë, më 1 qershor 1990: "Problemin e censurës e kemi dhe ne në Kushtetutën tonë, por ligj për ne është Platforma e Byrosë Politike." Kuptimi ishte që, fshehtësia e korrespondencës garantohej me Kushtetutë, por ministri i Punëve të Brendshme dhe gjithë ata që e dëgjonin, anëtarët e tjerë të Byrosë Politike, nuk pyesnin për respektimin e ligjit.

Nga veprimtaria e Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, të frymëzuara, autorizuar/urdhëruara, dhe të drejtuara me rreptësi nga PKSH/PPSH, u persekutuan mbi 42000 persona, të ndarë në këto kategori:

- 5505 - të ekzekutuar
- 14565 - të burgosur
- 987 - të vdekur në burg
- 263 - të sëmurë mendorë
- 20804 - të internuar/dëbuar

Këto shifra janë zyrtare, sipas aplikimeve për dëmshpërblim. Mund të ketë pasur aplikim shtesë këto 3-4 vitet e fundit, ose mund të ketë ende persona që nuk kanë aplikuar, por pjesa e dërmuese e viktimave janë identifikuar.

Të dhëna mbi personat e persekutuar për arsye politike gjatë periudhës së komunizmit gjenden dhe në veprën monumentale *Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terroit Komunist*, botim i ISKK, 10 vëllime deri tani, dhe parashikohen edhe dy vëllime të fundit.

VEPRA PENALE E GJENOCIDIT

Dokumenti i OKB, nr. 260 A (III), 9 dhjetor 1948, "Konventa për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit", vepra penale e gjenocidit, përkufizohet si:

Neni 2:

Në këtë Konventë, gjenocid quhet çdonjëri nga aktet pasuese i kryer me qëllim shkatërrimin, e plotë ose të pjeshëm, e një grupi për arsye të besimit fetar, racore, etnike ose kombëtare:

(a) vrasja e anëtarëve të grupit;

(b) lëndimi i rëndë fizik ose mental i anëtarëve të grupit;

(c) vënia e grupit qëllimisht në aso kushte të jetës që duhet të sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij;

(d) ndërmarrja e masave drejtuar në pengimin e lindjeve brenda grupit; dhe

(e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në tjetrin.

Konventa e OKB u miratua nga Shqipëria më 12 maj 1955, dhe përkufizimi i nenit 2 të saj u bë pjesë e Ligjit nr. 1470, 23 maj 1952, i ndryshuar, "Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë:

Neni 71

Gjenocidi d.m.th. veprat e kryera me qëllim për të shkatërruar plotësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si:

a-vrasja e anëtarëve të grupit

b-dëmtimi i rëndë trupor ose mendor, anëtarëve të grupit

c-vënia me qëllim e grupit në kushte jetese të atilla që shkaktojnë shkatërrimin e tij fizik të plotë ose të pjesshëm

d-masa që kanë për qëllim të ndalojnë lindjet në gjirin e grupit

d-transferimi me forcë i fëmijëve të grupit në një grup tjetër, dënohen me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje dhe kurdoherë me konfiskim të pasurisë

Nën drejtimin e PKSH/PPSH institucionet fetare, klerikët dhe besimtarët, u persekutuan që në vendosjen e regjimit komunist. Në fillim të vitit 1967 nisi një fushatë e dhunshme kundër institucioneve fetare, që ishte sulmi përfundimtar kundër tyre, e cila çoi në persekutimin e klerikëve dhe besimtarëve, të cilët ushtronin një të drejtë kushtetuese, në shkatërrimin e shumë objekteve fetare, në mbylljen ose tjetërsimin e objekteve që nuk u prishën, dhe në ndalimin e plotë të ushtrimit të lirisë së besimit fetar. Deri në fillim të korrikut 1967, u shkatërruan, mbyllën, apo u tjetërsuan 2169 objekte kulti: 740 xhami, 608 kisha ortodokse dhe manastire, 157 kisha katolike, 530 teqe, tyrbe, mekame, etj.

Ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë fetare u bë me Dekretin nr. 4337, 13 nëntor 1967. Juridikisht, dekreti nuk kishte fuqi mbi kushtetutën, por këtë fakt nuk e mori kush parasysh, ashtu siç nuk u kujtua kush për nenin 71 të Kodit Penal.

Liria e besimit fetar ekzistoi si e drejtë kushtetuese deri më 28 dhjetor 1976, kur doli kushtetuta e re, e cila e shpalli Shqipërinë një vend ateist.

PËRFUNDIME

Siç rezulton nga ky parashtrim, dhe literatura shkencore ku ai është bazuar, mund të konkludojmë se:

1. PKSH/PPSH u krijua dhe veproi gjatë gjithë periudhës së komunizmit si një organizatë e paligjshme.
2. PKSH/PPSH veproi si një entitet i huaj, jashtë korpusit ligjor të shtetit shqiptar.
3. Çdo vendim i PKSH/PPSH, çdo ndërveprim i saj me institucionet, çdo transaksion financiar, çdo manifestim publik, thuajse çdo veprim i saj, ishte vepër penale ose kundravajtje penale.
4. PKSH/PPSH e mbajti pushtetin me dhunë, duke kontrolluar plotësisht dhe pandërprerë organet e dhunës: Sigurimin e Shtetit, policinë, ushtrinë.
5. PKSH/PPSH ka frymëzuar, autorizuar/urdhëruar dhe drejtuar zbatueshmërinë e akteve të paligjshme:
 - a) ekzekutimin e personit
 - b) rrëmbimin e personit
 - c) heqjen e lirisë së personit të rrëmbyer
 - d) shtrëngimin personit të rrëmbyer
 - e) shpërnguljen e popullsisë
 - f) rekrutimin – vullnetar ose të detyruar – në shërbim të një entiteti të paligjshëm (Sigurimi i Shtetit)
 - g) përgjimin e paligjshëm (ai që quhet përpunim në platforma)
 - h) kontrollin e paligjshëm të korrespondencës etj.
6. Si pasojë e akteve të paligjshme të frymëzuara, autorizuara/urdhëruara, drejtuara nga PKSH/PPSH, gjatë periudhës së komunizmit u persekutuan mbi 42000 persona, shqiptarë e të huaj me banim në Shqipëri.
7. Në shkelje të Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Konventës së OKB për gjenocidin, e miratuar nga shtetit shqiptar, PKSH/PPSH frymëzoi, autorizoi/urdhëroi dhe drejtoi lëvizjen antikushtetuese kundër fesë (gjenocid), e përkufizuar në Kodin Penal dhe e ndëshkueshme prej tij.
8. Krimet e PKSH/PPSH nuk mund të mbeten veç punë e historianëve dhe t'i përcillen publikut si një kuriozitet. Deri tani institucionet kanë treguar ndjeshmëri ndaj viktimave të komunizmit, me një numër ligjesh dhe procedurash të tjera, por nuk kanë bërë shumë për vënien përpara përgjegjësisë të personave të përfshirë në organizmin dhe kryerjen e këtyre krimeve. Krimet e regjimit komunist ishin në masë të gjerë, por nuk ishin pasojë e dukurive natyrore, që institucionet post komuniste të merren vetëm me riparimin e dëmeve (sa mund të riparohen), dhe të mos bëjnë asgjë për vendosjen e drejtësisë. Gjenocidi, për shembull, është një vepër penale që nuk parashkruhet, por denoncimi nuk duhet lënë në vullnetin e qytetarëve, të cilët nuk kanë as njohjen e duhur ligjore, as mjetet e domosdoshme financiare, as mbrojtje ligjore të posaçme dhe, ndoshta, as kohën

e nevojshme në dispozicion. Ndjekja ligjore e veprave penale të tilla nuk mund të lihet as në dorë të institucioneve ekzistuese të zbatimit të ligjit, të cilat mund ta zvarrisin procesin me justifikimin e spektrit të gjerë të punës që parashikon korniza ligjore ekzistuese. Për më tepër, veprat penale për të cilat bëhen fjalë në këtë raport janë kryer me frymëzimin, autorizimin/urdhërimin, drejtimin e një entiteti të paligjshëm, i cili ka vepruar në emër të shtetit shqiptar, dhe shteti e ka detyrim të pastrojë veten nga pesha e krimit me të cilin është identifikuar për një periudhë të gjatë.

9. Objektet publike – godina, sheshe, rrugë, fshatra e qytete, etj. – nuk mund të vazhdojnë të mbajnë emërtime të vendosura gjatë regjimit komunist për qëllime propagandistike, për të forcuar pushtetin e një organizate të paligjshme, siç ishte PKSH/PPSH, dhe për të mbajtur në këmbë një strukturë kriminale dhe të paligjshme, siç ishte diktatura komuniste.
10. Institucionet shqiptare nuk mund të vazhdojnë të kenë pjesë të tyre njerëz që i kanë shërbyer me devotshmëri PKSH/PPSH dhe diktaturës së saj. Institucionet e sotme të shtetit shqiptar kanë nevojë për njerëz me formim të pa ndikuar nga ideologjia komuniste, e cila prodhoi veç dhunë dhe varfëri, në Shqipëri e kudo në botë. Një gjë e tillë mund të rregullohet me amendime ligjore, të cilat të kenë në fuqi të paktën deri në vitin kur ka dalë në pension gjenerata që ka nisur punë vitin e parë të rënies së regjimit komunist.
11. Historianët dhe studiuesit e të gjitha llojeve vazhdojnë ta quajnë PKSH/PPSH një parti politike, duke mos i kushtuar vëmendje statusit juridik të saj dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së saj. Historia e PKSH/PPSH, e shkruar gjatë regjimit komunist, vazhdon të përsëritet në tekstet e sotme, ndërkohë, bazuar në materialet e bollshme të botuara ndër vite, PKSH/PPSH nuk mund të konsiderohet parti politike, edhe sikur t'i referohemi vetëm përkufizimit politik, sepse dihet që ajo nuk u kufizua në marrjen e pushtetit me mjete politike. ISKK ka botuar shumë dokumente që vërtetojnë vrasjet e kryera në emër të partisë nga komunistët. Edhe struktura që quhej Komitet Qendror i PKSH/PPSH ka dhënë dënime me vdekje, para dhe pas marrjes së pushtetit.

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Shqipërisë duhet të plotësojë kornizën ligjore të drejtësisë tranzitore me dispozita detyruese dhe ndëshkuese për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të kryera gjatë periudhës së komunizmit, të cilat janë frymëzuar, autorizuar/urdhëruar dhe drejtuar nga PKSH/PPSH.
2. Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndalojë me instrumente juridike promovimin e PKSH/PPSH dhe diktaturës komuniste:
 - a. Të ndalojë ekspozimin e simboleve komuniste.

- b. Të ndalojë emërtimin e objekteve publike – rrugë, godina, qytete, fshatra, etj. – me emra komunistësh ose personave që i kanë shërbyer PKSH/PPSH dhe regjimit diktatorial të saj.
 - c. Të ndalohen objektet përkujtimore të krijuara gjatë regjimit për glorifikimin e PKSH/PPSH ose anëtarëve të saj.
 - d. Të hiqen datat përkujtimore ose datat festive që janë të lidhura me historinë e PKSH/PPSH dhe të vendosura gjatë regjimit komunist.
 - e. Të rregullojë mënyrën e shfaqjes/publikimit/ekspozimit të prodhimeve propagandistike të regjimit komunist.
3. Kuvendi i Shqipërisë duhet të mbrojë me mjete juridike institucionet e administratës dhe institucioneve të pavarura nga ndikimi i ideologjisë totalitare të PKSH/PPSH:
- a. Të plotësojë ligjin për administratën, Kodin e Punës apo ligje të tjera që kanë kritere punësimi, përfshi ligjin e zgjedhjeve – pjesa e kritereve të kandidimit – me kriteret e veçanta të parashikuara në nenin 18, pika 1, të ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.
 - b. Periudha e zbatimit të kritereve të veçanta për punësim dhe kandidim të lihet me efekt deri në vitin 2038.

LITERATURA MBËSHTETËSE PËR KËTË RAPORT:

Artikuj shkencorë:

- Afrim Krasniqi, “Baza dhe konceptet kushtetuese në vendimarrjet mbi sistemin qeverisës: Analizë krahasimore, vitet e para (1945-1946) dhe të fundit (1990) të regjimit komunist.” *Memoria I*, nr. 1, 45-67.
- Çelo Hoxha, “Kontruksioni ligjor i regjimit komunist në Shqipëri.” *Memoria I*, nr. 1, 9-44.
- Çelo Hoxha, “Paligjshmëria e vendimeve të internim-dëbimit në periudhën 1944-1954,” në: *Të mohuar nga regjimi: përmbledhje e kumtesave dhe referateve të mbajtura në Konferencën e organizuar nga AIDSSH, 30-31 tetor 2018* (Tiranë: AIDSSH, 2018), 283-297.
- Çelo Hoxha, “Marrëdhëniet e besimeve fetare me shtetin gjatë regjimit komunist në Shqipëri krahasuar me regjimet komuniste të Europës Lindore (1960-1967),” në: *Kërkime të reja për historinë e Shqiptarëve: Kumtesa të mbajtura në Konferencën Shkencore, organizuar nga Shkolla Doktorale e Institutit të Historisë, 15 dhjetor 2015* (Tiranë: Instituti i Historisë, 2017), 157-176.
- Çelo Hoxha, “Vështrim mbi legjitimitetin e Kongresit të Përmetit.” *Studime Historike LXX (LIII)*, nr. 3-4, 2016, 191-208.

- Engjëll Likmeta, “Aspekte të legjislacionit dhe mendimit juridik në fushën e së drejtës penale në Shqipërinë moniste.” *Memoria I*, nr. 1, 68-108.
- Erind Mërkuri, “Supremacia dhe kontrolli kushtetues gjatë regjimit komunist,” në: *Aktet e konferencës shkencore: Ligjshmëria gjatë regjimit komunist 1944-1990* (ISKK, 2021), 77-103.
- Florin Zyberaj, “Korniza ligjore e Gjyqit Special”, revista *Memoria I*, nr. 1, 120-144.
- Hasan Bello, “Marrëdhëniet juridike të komuniteteve fetare,” në: *Aktet e konferencës shkencore: Ligjshmëria gjatë regjimit komunist 1944-1990* (ISKK, 2021), 9-14.
- Xhaferr Sadiku, “Ligjshmëria e kolektivizimit të bujqësisë dhe luftës së klasave.” *Memoria I*, nr. 1, 109-119.

Vepra studimore

- Alvin Saraçi, *Konfiskimi i pronës dhe grabitja e arit 1944-1945* (Tiranë: ISKK, 2012).
- Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm* (Tiranë: ISKK, 2012).
- Çelo Hoxha, *Fillimet e diktatures komuniste*, (Tiranë: ISKK, 2013).
- Enver Lepenica, *Eliminimi i grupit komunist të të Rinjve* (Tiranë: ISKK, 2016).
- Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2015).
- Kastriot Dervishi, *Vrasjet në kufi në vitin 1990* (Tiranë: ISKK, 2015).
- Kastriot Dervishi, *Terrori komunist i vitit 1951* (Tiranë: ISKK, 2017).
- Luan Dode, *Partia Komuniste Shqiptare gjatë luftës së dytë botërore* (Tiranë: ISKK, 2021).
- Preng Gjomarkaj, *Mirdita nën terrorin komunist* (Tiranë: ISKK, 2016).
- Xhafer Sadiku, *Genocidi mbi kulakët në Shqipërinë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2013).
- Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur* (Tiranë: ISKK, 2016).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist I*, (Tiranë: ISKK, 2012).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist II*, (Tiranë: ISKK, 2013).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist III*, (Tiranë: ISKK, 2014).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist IV*, (Tiranë: ISKK, 2015).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist V*, (Tiranë: ISKK, 2016).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist VI*, (Tiranë: ISKK, 2017).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist VII*, (Tiranë: ISKK, 2018).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist VIII*, (Tiranë: ISKK, 2019).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist IX*, (Tiranë: ISKK, 2020).
- *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist (shëresa 1)*, (Tiranë: ISKK, 2021).

Përmbledhje me dokumente

- Alvin Saraçi, *Dokumente mbi cënimin e pronës në periudhën komuniste* (Tiranë: ISKK, 2021).
- Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2014).
- Çelo Hoxha, *Krimet e komunistëve gjatë luftës 1941-45* (Tiranë: ISKK, 2014).
- Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës* (Tiranë: ISKK, 2017).
- Vasfi Baruti, *Ferri komunist i gjyqeve politike* (Tiranë: ISKK, 2016).

Kujtime, intervista

- Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës I (Tiranë: ISKK, 2014).
- Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës II (Tiranë: ISKK, 2015).
- Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës III (Tiranë: ISKK, 2016).
- Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës IV (Tiranë: ISKK, 2017).
- Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës V (Tiranë: ISKK, 2018).
- Fatbardha Saraçi (Mulleti), *Kalvari i grave në burgjet e komunizmit* (Tiranë: ISKK, 2014).
- Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës VI (Tiranë: ISKK, 2021).
- Luljeta Lleshanaku (red. përgjegjës), Zërat e kujtesës VII (Tiranë: ISKK, 2021).
- Mhill Gjinaj, *Me litar në fyt* (Tiranë: ISKK, 2017).

DREJTORI EKZEKUTIV

Celo Hoxha



